

NOTER



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER VALBONA P. SINANI
ADRESA NR.2, GEORGE W. BUSH,
PALL "ALBSIG", NR.1, NR.12
TEL: 693326497

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3694

Nr. koleksioni: 1217

Tirane më 17/10/2024

Digitally signed by
VALBONA SINANI

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024051460141058832

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë

REPUBLIC OF
LIBERIA
JAN 17 1994



A2024051460141058832



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË " **BUFALO ALBANIA** " SH.P.K)

Sot, më datë 17.10.2024, para meje Noterë VALBONA P. SINANI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, GEORGE W. BUSH, PALL"ALBSIG", NR.1, NR.12, u paraqit personalisht:

SHITES:

VIOLETA SHEHAJ, atësia Sali, amësia Hatixhe, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në adresë Osman Haxhiu Vlorë, lindur më 02/01/1956, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033832505 dhe nr. personal F65102075I, **ne cilesine e ortakes se Shoqerise BUFALO ALBANIA me NUIS M4652902J me 25% te kuotave.**

NAJADA HODAJ, atësia Laver, amësia Nazllije, shtetase Shqiptare, lindur në Lushnjë, Lushnje dhe banuese në adresë Muhamet Gjollësja; Tiranë, lindur më 05/06/1978, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033250835 dhe nr. personal H85605065M, **ne cilesine e ortakes se Shoqerise BUFALO ALBANIA me NUIS M4652902J me 75% te kuotave.**

BLERES:

GENARD KASTRATI, atësia Maliq, amësia Hyrie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në adresë Njazi Meka; Tiranë, lindur më 12/06/1978, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036504049 dhe nr. personal H80612130F.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "**BUFALO ALBANIA**" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Baza Ligjore

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- Neni 761 e vijues të Kodit Civil
- Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar
- Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Shoqeria " **BUFALO ALBANIA** "shpk, e themeluar me date 21.03.2024 dhe e regjistruar ne Q.K.B date 29.03.2024, me N.I.P.T M46529202J, me Administrator **VIOLETA SHEHAJ** dhe Ortak **NAJADA HODAJ**, zoterues i 1,00 te kuotave qe perfaqeson 75% te kapitalit fillestar ne shumen 75.000,00 leke, dhe **VIOLETA SHEHAJ** zoterues i 1,00 te kuotave qe perfaqeson 25% te kapitalit fillestar ne shumen 25.000,00 leke, me objekt veprimtarie sipas statutit dhe aktit te themelimit.



A2024051460141058832

Ortakët e Shoqërisë “**BUFALO ALBANIA**” shpk, **NAJADA HODAJ** dhe **VIOLETA SHEHAJ**, me vendimin date 16.10.2024 të asamblese së ortakëve kanë vendosur shitjen nepermjet kontrates së shitjes së 100 % të kuotave të kapitalit që zoterojnë në këtë shoqëri, bleresit **GENARD KASTRATI** dhe largimin e tyre si ortak dhe largimin e **VIOLETA SHEHAJ** si administrator e shoqërisë “**BUFALO ALBANIA**” shpk.

NENI 2

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

Çmimi total i Shitjes për shitjen e kuotave të kapitalit dhe është në shumën prej **100.000,00 leke** (njqindmijë leke).

Pagesa është likuiduar mes paleve jashtë kësaj zyre noteriale përpara nënshkrimit të kësaj kontrate dhe palet nuk kanë asnjë pretendim financiar kundrejt njerit tjetrit në lidhje me shitjen e kuotave të Shoqërisë “**BUFALO ALBANIA**” sh.p.k. as sot dhe as në të ardhmen.

Kjo Kontrate do të regjistrohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit në momentin e nënshkrimit të saj nga palet, brenda afatit të përcaktuar në ligj.

NENI 3

DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITESIT

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitblerje të kuotave të kapitalit nga palet, Shitesit **NAJADA HODAJ** dhe **VIOLETA SHEHAJ** marrin përsipër detyrimin të transferojnë titullin e pronësisë së kuotave të kapitalit të Blerësi.

Në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate shitblerje, Shitesit **NAJADA HODAJ** dhe **VIOLETA SHEHAJ** do të zhvishen nga pronësia dhe zotërimi i 100 % të kuotave të kapitalit themeltar, largohen perfundimisht nga shoqëria “**BUFALO ALBANIA**” shpk, si ortak të Shoqërisë dhe **VIOLETA SHEHAJ** largohet si administrator i shoqërisë “**BUFALO ALBANIA**” shpk.

Pas regjistrimit të saj pranë organit perkates, ortak i vetëm, i shoqërisë “**BUFALO ALBANIA**” shpk me 100 % të kuotave të kapitalit themeltar, behet bleresi **GENARD KASTRATI**. Administrator do të behet **Znj. KLEJDJA KASTRATI** mbajtëse e Leternjoftimi ID me Nr. personal H95810050U.

- Shitesit deklarojnë dhe garantojnë se tatimi në burim në shtet është detyrim i tyre.
- Shitesit deklarojnë dhe garantojnë se për çdo gjë, penalitet, pagesë të prapambetur në shtet si takse/tatim e jo vetëm, përgjegjes për likuidimin e saj është vetëm pala shitesë pavarësisht faktit nëse bleresi ka dijeni apo jo për të.
- Shitesit deklarojnë dhe garantojnë se janë pronarë dhe përfitues të vetëm dhe të ligjshëm të gjithë kuotës që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë “**BUFALO ALBANIA**” sh.p.k.
- Kuota që shitet është e lirë dhe e çliruar nga çdo barrë e çfarëdo lloji dhe Shitesit kanë të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t’i shitur, për t’i kaluar, transferuar dhe dorëzuar kuotat.
- Asnjë person nuk pretendon se ka ndonjë të drejtë lidhur me ndonjë nga kuotat e shoqërisë “**BUFALO ALBANIA**” sh.p.k.
- Shitesit garantojnë se çdo detyrim të papaguar, takse që shoqëria “**BUFALO ALBANIA**” sh.p.k. ka në momentin e nënshkrimit të kontrates do të paguhet prej tyre dhe nuk kanë rënë dakord të krijojnë ose të marrin hua, të marrin borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes, nuk janë palë dhe nuk janë përgjegjës në bazë të ndonjë marrëveshjeje sigurorese, dëmshpërblimi ose



A2024051460141058832

marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një pale të tretë.

- Shitesit deklarojnë se nuk kanë asnjë proces gjyqësor civil, penal, apo administrativ dhe as në ngarkim të shoqërisë në Republikën e Shqipërisë me objekt kuotat e tyre.
- Shitesit do të mbajnë të pacënuar Bleresin për çdo detyrim tatimor të paparashikueshëm që rrjedh nga akte, fakte ose mosveprime të ndodhura para nënshkrimit të kontratës.
- Shitesit do të mbajnë të pacënuar Bleresin nga çdo dhe të gjitha pretendimet e bëra nga palët e treta, si për shembull por jo në mënyrë shteruese: shumat e detyrueshme për palët e treta në përgjithësi për çdo titull ose arsye dhe çdo detyrim tjetër.

NENI 4

DEKLARIMET DHE GARANCITË E BLERËSIT

Bleresi garanton Shitesin se ka të gjithë autorizimin për të nënshkruar këtë kontratë dhe ka kompetenca dhe autoritet të plotë të kryejë aktivitetin e tij.

NENI 5

REGJISTRIMI I KONTRATËS

Kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali do të regjistrohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit nga pala blerese në regjistrin e kuotave të shoqërisë dhe në Regjistrin Tregtar në përputhje me ligjin në momentin e likuidimit të cmimit të plotë të shitjes.

NENI 6

FORCA MADHORE

- Mospërbushja e detyrimeve sipas kësaj kontrate prej njëres nga Palët, nuk do të quhet shkelje ose mospërbushje e kësaj kontrate, në rast se kjo mospërbushje vjen si pasojë e një force madhore, me kusht që Pala e prekur nga kjo ngjarje (a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, përkujdesjen e duhur dhe masa të ndryshme të arsyeshme, për të përmbushur afatet dhe kushtet e kësaj kontrate, dhe (b) të ketë njoftuar Palën tjetër sa më shpejt e mundur për këtë ngjarje.
- Çdo periudhë brenda së cilës, njëra nga Palët sipas kësaj Kontrate, duhet të kryejë një veprim ose detyrë, do të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me periudhën gjatë së cilës kjo Palë, nuk mund të kryejë këtë veprim për shkak të forcës madhore.

NENI 7

PËRFUNDIMI I KONTRATËS

Me nënshkrimin e rregullt nga palët kjo kontratë konsiderohet e përfunduar me sukses.

NENI 8

ZGJIDHJA E KONTRATËS

Kjo kontratë mund të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet Shitesit dhe Bleresit, duke i kthyer palët në gjendjen fillestare siç ishin para nënshkrimit të kësaj kontrate ose sipas kushteve të parashikuara në këtë kontratë. Kjo kontratë mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga pala shitesë nëse nuk respektohet afati i pagesës së cmimit të plotë të shitjes.

NENI 9

INTERPRETIMI I KONTRATËS

Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët. Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve që i ka shtyrë për nënshkrimin e aktit.



A2024051460141058832

NENI 10 NJOFTIMET

- Çdo njoftim mbi ekzekutimin e kësaj kontrate, pretendime të tjera apo edhe zgjidhjen e saj, do të njoftohet me shkrim.
- Secila palë kontraktore ka detyrimin që të njoftojë tjetrën për çdo ndryshim të dhënave të adresës së saj, në të kundërt nuk ka vend për përgjegjësi kundrejt palës tjetër. Në rast se nuk përmbushet ky detyrim, pala që ka kryer njoftimin konsiderohet se e ka përmbushur detyrimin.

NENI 11 ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksë të Kontratës;

- Vendimi i Ortakut të Shoqërise datë 16.10.2024;
- Ekstrakt i Regjistrisë Tregtare për Shoqërinë “**BUFALO ALBANIA**” Sh.p.k.;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

VIOLETA SHEHAJ & NAJADA HODAJ

Violeta Shehaj

Najada Hodaj


Najada Hodaj

BLERES

GENARD KASTRATI

Genard Kastati

Genard Kastati



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M46529202J
2. Data e Regjistrimit	29/03/2024
3. Emri i Subjektit	BUFALO ALBANIA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	21/03/2024
6. Kohëzgjatja	Nga: 21/03/2024
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Vlore Vlore Lagjja “Kushtrimi”, ne kryqëzimin e rrugës “Gjergj Kastrioti” dhe rrugës “Haxhi Xhyheri”, pranë shkollës private të arsimit parauniversitar “Xhyheri”, godina tri-katëshe, kati i parë, pasuria numër 7/46-2 9403
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Prodhim, përpunim i produkteve të qumështit dhe nënprodukteve të tij, si dhe tregtim i tyre. Tregti me shumicë e pakicë mallra të ndryshme ushqimore, bujqësore, blegtorale, pije të ndryshme. Import dhe eksport i produktit të qumështit dhe nënprodukteve të tij si djath, gjalpë etj. Import, eksport, shitje me shumicë e pakicë të nënprodukteve shtatëzore dhe nën produkteve të tjerë për pizza si ullinjë, miell, salcë etj. Import, eksport, ofrim asistencë teknike dhe shitje e blerje me shumicë e pakicë të pajisjeve mjekësore apo të medikamenteve mjekësore të ndryshme. Si objekt të veprimtarisë së saj shoqëria do të ketë edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik të lejuar nga legjislacioni shqiptar, që përputhet me objektin e veprimtarisë së saj dhe që kanë rëndësi për arritjen e objektivave të shoqërisë.
10. Administratori/ët	Violeta Shehaj
10.1 Afati i emërimit	Nga: 21/03/2024 Deri: 21/03/2029
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	
12. Ortakët	NajadaHodaj

12.1 Vlera e kapitalit	Para: 75.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	75,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Ortakët	VioletaShehaj	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 25.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	25,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: BUFALO ALBANIA E-Mail: violetashehaj@outlook.com Telefon: 0698510229	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 17/10/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)